Kronikë

Lezhë/ Konflikt i çastit mes dy të rinjve, tentohet të vritet me armë 33-vjeçari në Shënkoll! Policia arreston autorin, sekuestron pistoletën (EMRI)

Menjëherë pas ngjarjes, autori 32-vjeçar është arrestuar nga policia. Sekuestrohen arma e krimit dhe 2 gëzhoja. Dyshohet se incidenti ka ndodhur pas një konflikti të çastit mes dy të rinjve

Pistoleta e krimit dhe gëzhojat e sekuestruara

Redaksia
9 Shkurt, 19:26 | **Përditesimi: 9 Shkurt, 19:48**

Share

LEZHË - Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar mesditën e sotme në fshatin Shënkoll të Lezhës.

Sipas burimeve, një person ka qëlluar me pistoletë ndaj një automjeti, me qëllim për të vrarë një 33-vjeçar me të cilin ishte në konflikt, por fatmirësisht nuk ka pasur të lënduar.

Policia vendore tha se arrestuan pas hetimeve të dyshuarin Danjel Nikolli si autor.

LEXO EDHE:
Dielli i dimrit tërheq qytetarët në bregdetin e Shëngjinit: Na pëlqen shumë ajri i pastër

> *"Shërbimet e Policisë kanë kapur dhe vënë në pranga për veprat penale "vrasja e mbetur në tentativë" dhe "prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", shtetasin D. N., 32 vjeç, (Danjel Nikolli), banues në Shënkoll, Lezhë. Ky shtetas për motive të dobëta është konfliktuar fizikisht me shtetasin E.T., dhe më pas ka qëlluar dy herë me armë zjarri pistoletë në drejtim të tij për ta vrarë", njofton policia vendore.*

Grupi hetimor ka marrë si provë materiale edhe armën e zjarrit me dy gëzhoja, kurse dosja i kaloi prokurorisë vendore.

Dyshohet se incidenti ka ndodhur pas një konflikti të çastit mes dy të rinjve. Ndërkohë, Policia e Lezhës po vijon punën për zbardhjen e plotë dhe nëse ka persona të tjerë të përfshirë në konflikt.

G.K/A.Q/Shqiptarja.com

TAG: danjel nikolli | te shtena armesh | shenkoll | Lezhe

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligjit 35/2016

Sondazhi i ditës:
8 Shkurt, 14:29
Berisha planifikon të shpërbëjë SPAK nëse fiton më 11 maj, çfarë mendoni?

Ka të drejtë | Gabon | Nuk e di

Lajme të tjera

Gjin Gjoni, ish-gjyqtari i besuar i Berishës synon të futet në kuvend! Dorëhiqet si kryetar dege, do të futet në primare
8 Shkurt, 11:03

Lezhë/ Motorët përplasen mes tyre në Dragushë, plagoset rëndë një nga drejtuesit! Niset për te Spitali i Traumës
7 Shkurt, 19:12

Lezhë/ 25 vjeçari u gjet i vdekur në makinë, çfarë filmuan kamerat dhe pista kryesore e hetimit
Elvis Hila
7 Shkurt, 11:05

Arratisja e Daut Lazes nga burgu i Shënkollit, Gjykata e Lezhës liron nga qelia 3 punonjësit! Arrest në shtëpi për gardianët, detyrim paraqitje për operatoren e kamerave
Elvis Hila
7 Shkurt, 09:41



Lezhë/ 25-vjeçari gjendet i vrarë me një plumb brenda në makinë, nuk dihen rrethanat! Në mjet edhe arma, ja pistat e hetimit (EMRI+VIDEO)
6 Shkurt, 17:14

Lezhë, 12 familje refuzojnë të lirojnë godinën ku do ndërtohet azili! Bashkia: U kemi ofruar bonusin e qirasë
Elvis Hila
6 Shkurt, 15:59

Siguria në vend, ekspert i Kriminalistikës në Report Tv: Ekziston, në Shkodër RENEA duhet të ishte stacionare! Policia e ka përgjigjen për zhdukjen e Ervis Martinajt
5 Shkurt, 14:48

Arratisja nga burgu i Shënkollit, i dënuari kapërceu murin 4 metra me llamarinë! Report Tv në banesën e tij në Tiranë, nëna: S'e di ku është! Kontrolle në xhami
Sokol Dema
5 Shkurt, 11:59

Arratisja e të dënuarit për dhunë në familje nga burgu i Shënkollit, 3 punonjës në pranga! Ja zonat ku po kërkohet 49-vjeçari (EMRAT)
Elvis Hila
5 Shkurt, 07:09

Lezhë/ I dënuari për dhunë në familje arratiset nga burgu i Shënkollit! Paraqet rrezikshmëri shoqërore, shpërblim 10 000 euro kush ka informacion(EMRI+ FOTO)
Elvis Hila
4 Shkurt, 08:07

Politico: Si u hodh në erë plani i Melonit për emigrantët në Shqipëri
3 Shkurt, 14:35

Aksident në Lezhë, automjeti i pastrimit humb kontrollin dhe përmbyset në rrugë, plagoset shoferi
3 Shkurt, 10:16

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje